



KUVENDI I KOMUNËS

KOMITETI PËR KOMUNITETE

Procesverbal nga mbledhja e XXXII-të (tridhjetedy - mandati VII), e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 08 prill 2024

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, dhe filloi në orën 10;10

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: znj.Qëndresë Hajrizi, z.Florent Hasani, z.Arbnor Fazliu, znj.Shkurte Sejdiu, znj.Sevdije Mustafa, z.Selver Rama, z.Demokrat Hodolli, znj.Fikmete Qurkolli.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe; Liman Zeqiri-shef i Zyrës Komunale për Komuniteteve dhe Kthim ZKKK; Driton Shabani nga Stacioni i Policisë në Podujevë; Shefqet Ismajli nga Stacioni i Policisë në Podujevë; Bekim Karaxhija përfaqësues i OSBE; Zita Rasztk përfaqësuese e KFOR-it, Benjamin Bognar përfaqësues i KFOR-it

Rendi i ditës

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe iu dëshiroj mirëseardhje në këtë mbledhje, ndër të tjera, theksoi, thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje besoj e keni marrë me kohë, andaj në vazhdim po lexoj rendin e ditës dhe njëkohësisht pyes nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim rendin e ditës.

Njëzëri me 9 vota Për, nga anëtarët e Komitetit, miratohet rendi i ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje.

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 05.03.2025

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth këtij procesverbali për ndonjë vërejtje gjatë diskutimit nëse jo e hedh në votim.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim ndryshime miratohet procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 05.03.2025.

2. Informatë e Kryesuesit të Komitetit për Komunitete në koordinim me Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim – ZKKK për vizitat në lagjet ku banojnë komunitetet jo shumicë, përkatësisht në rr.”Ali Ajeti”, dhe në rr. Xhemajl Mustafa”- (në afërsi të Gjimnazit “Aleksandër Xhuvani”) në qytetin e Podujevës.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, këtë vizitë që kemi bërë nga komuniteti kemi marrë informata dhe shqetësim i komunitetit është uji i cili nuk është i pijshëm prandaj në rr.”Ali Ajeti” ku jetojnë komunitetet uji është një brengë e madhe sepse gypat e ujësjellësit janë të azbestit dhe janë ndryshkur dhe uji vjen i turbullt, një organizatë ka qenë e ka bërë matjen dhe ka konstatuar se ai ujë është i pa pijshëm, por komuniteti po e përdor edhe pse këtu e kemi paraqit atë problem. Është bërë plani i komunës ku e falënderoj më së shumti z.Liman Zeqiri i cili deri në momentin e fundit nuk është ndalë deri në realizimin e atij projekti, projekti është bërë dhe na ka premtuar ish ministri Elbert Krasniqi, realizimin e atij projekti të cilin në fund nuk e realizoj. Këtë projekt e kam marrë dhe e kam dërguar në ujësjellës në Prishtinë edhe pse atje na kanë premtuar realizimin e këtij projekti por prapë ky projekt nuk është realizuar, ku qëndron faji nuk e dimë dhe kjo është një brengë shumë e madhe e komunitetit. Një pjesë e rr.”Ali Ajeti” nuk ka ndriçim, aty ka qenë ndriçimi por kur është bërë ndërrimi i shtyllave nga KEDS, aty njëra pjesë e rrugës është me ndriçim kurse tjetra nuk është edhe këtë shqetësim e kemi paraqit shumë herë por prapë nuk është realizuar, kështu që edhe unë si kryesues i komitetit po kam probleme me komunitetet se po vijnë e po më thonë se nuk po realizohen kërkesat e tyre dhe në fund unë prapë po mbes fajtor. Sa i përket punësimit edhe pse është bërë një zbutje sepse disa prej banorëve të komuniteteve që jetojnë në rr.”Ali Ajeti” janë punësuar në pastrim disa të tjerë janë punësuar në një fabrikë në Prishtinë e pronarin e saj e falënderojmë se i ka marrë 12 apo 13 punëtor por prapë kemi një numër bukur të madh që presin të punësohen e kryesisht janë djem të ri por prapë kemi një numër bukur të madh të pa punësuar që janë djem të ri, nuk e di pse nuk kemi mund të kontaktojmë me QPS-në edhe pse i kemi thirr e nuk kanë ardhë ata të entit për punësim me i marrë disa djem të ri që kanë mbet me shkollë të mesme të cilët nuk kanë mund të punësohen prandaj këta me i marrë e me i dërgua në zanat se po bëhen disa kurse të zanateve dhe është më lehtë të punësohen pas përfundimit të kurseve të zanateve se sa me shkollë të mesme, kjo ishte. Sa i përket ndërtimit të shtëpive edhe pse në lagje është bërë ndërtim i mirë, nuk mund të themi për momentin se nuk ka ndërtim, ndërtim ka pas nga vet kontribuuesit që i kanë ndërtuar shtëpitë, kemi nevojë për ndërtim por problemin kryesor e kemi me ata që nuk kanë prona ose e kanë pronën por se kanë të rrexhistruar në mënyrë legale dhe me ardhë një projekt për ndërtimin e shtëpive me të vërtetë ata që kanë nevojë nuk po mundën të përfitojnë ky është problemi kryesor prandaj duhet të bisedojmë me zyrtarët e komunës se si mund të bëjmë rrexhistrimin e pronave edhe pse s’kanë mjete se disa po thonë se s’kemi mjete financiare, andaj me ua mundësua rrexhistrimin e pronës. Gjithashtu ka nevojë për meremetimin e disa shtëpive që janë ndërtuar më herët mirëpo ka nevojë edhe për disa projekte tjera por në qeveri shkaku kryesor po e përmendi është se pronat nuk janë të legalizuara, nuk janë pronat në emër të pronarëve dhe nuk po mundemi me arrit deri te përfitimi i atyre projekteve edhe pse kemi aplikuar për 70 familje dhe kur ka ardhë koha ato nuk kanë përfituar kjo është arsyeja. Në rr.”Ali Ajeti” është bërë asfaltimi mirëpo me shtrirjen e rrjetit të ujit dhe kanalizimit janë bërë prishje në rrugë dhe kjo rrugë ka nevojë prapë që të asfaltohet. Këto janë të gjitha kërkesat dhe shqetësimet e banorëve që na kanë paraqitë gjatë vizitës që kemi bërë me z.Liman Zeqirin, nëse dikush ka për të thënë rreth kësaj pike të rendit të ditës urdhëroni.

z.Florent Hasani, theksoi, po e ndaj një informatë pasi që ka dështuar për herë të parë kontrata për ujësjellësin tash janë nda prapë 95,000€ nga qeveria për këtë projekt që besoj se shumë shpejt do të fillojnë punimet për realizimin e tij.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, faleminderit shumë për këtë informatë apo këtë lajm të bukur sepse jemi duke prit realizimin e këtij projekti me vite.

z.Liman Zeqiri-shef i Zyrës Komunale për Komuniteteve dhe Kthim ZKKK, theksoi, e falënderojmë shumë asamblistin z.Florent Hasani që na e dha këtë lajm të mirë se kjo ka qenë kërkesë prej vitit 2022, që e kemi dërguar në qeveri, ne kemi biseduar disa herë për çështjen e ujësjellësit si në aspektin shëndetësor por ky është një lajm i mirë që rrjeti i ujësjellësit do të rregullohet. Ne e dimë që në rr.”Ali Ajeti” jeton numri më i madh i komuniteteve jo shumicë, me kërkesën e banorëve së bashku me z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit e kemi vizituar këtë lagje ashtu siç e kemi edhe me planin e punës, por në plan ne mund t’i ndryshojmë datat në mënyrë që t’i vizitojmë edhe lagjet tjera por pas kërkesave që kam pas në zyre e pash të arsyeshme që së bashku me kryesuesin ta vizitojmë këtë lagje dhe t’i shohim kërkesat e tyre, çdo herë çdo vit e kam vizituar këtë lagje duke parë që numerikisht është lagjia më e madhe dhe të gjitha hallet e dertet njeriu mund t’i shoh në vend të ngjarjes dhe bindet me atë de fakto për kërkesat e tyre. Normalisht në këtë lagje nga komuniteti ashkali janë 71 familje me 388 banor, do të thotë është komuniteti shumicë i komunitetit ashkali, njëkohësisht në këtë lagje jetojnë edhe komuniteti rom që janë 9 familje me 67 banor, normalisht në këtë lagje është interesant se këta jetojnë së bashku me komunitetin shumicë. Është normale për të gjitha që ato i ceke ti dhe është normale që infrastruktura deri dikund është e rregulluar, parësore ka qenë ta quaj rrjetin e ujësjellësit ku e dimë se ata gypa kanë qenë të azbestit mirëpo me këtë sistemin e ri kjo është e mirëseardhur në komunën tonë por edhe me nivelin qendror që kemi hulumtuar që ky projekt të realizohet. Sa i përket çështjes së banimit normalisht që çdo herë kemi raste të reja, ajo që më ka shqetësuar më së shumti është çështja e legalizimit të pronave, ne e dimë që shumica absolute nuk i kanë pronat në emrin e tyre dhe kjo është një pengesë e rregullimit të dokumentacionit që e kemi dërguar në qeveri e sidomos në ato digasteret kryesore që është ministria për komunitete dhe kthim, si dhe te ministria e pushtetit lokal që de fakto e de juro kanë kërkuar dokumentin që duhet me qenë pronari me dokumentacionin e tij që me ardhë deri te përfitimi i një objekti apo shtëpie megjithatë ne e kemi paraqitë këtë çështje edhe te noteri për ta realizuar këtë por dihet se edhe ne shumica nuk e kemi pronën në emrin tonë megjithatë këtë element është mirë ta neutralizojmë ta quaj kushtimisht që mundet me qenë prona në emër të babës, gjyshit apo stërgjyshit, për me ardhë deri te përfitimi më i lehtë. Ka raste që pronën e kanë në emrin e tyre por janë në pritje, mendoj se me formimin e qeverisë do të merren për bazë dhe mendoj që në të ardhmen do t’i kemi edhe ne parasysh këto familje që kanë nevojë për strehë sa më shpejtë t’i ndërtohen shtëpitë por me donator të mundshëm, shumica e tyre absolute kanë nevojë edhe për rinovim të shtëpive dhe këto kërkesa janë imediate, kanë nevojë edhe për sanitari mirëpo mendoj që ne duhet të jemi aktiv të gjithë dhe të japim kontributin tonë që sa do ku do ta zbusim edhe këtë çështje se banimi është çështja apo brenga numër një. Atë që e potencove është mirë kjo zbutja e papunësisë që është në tregun e lirë që shumica e firmave private janë duke i realizuar këto edhe kërkesa është e madhe dhe nga enti i punësimit ne kemi kërkuar dy herë mbledhje me ta për nevojat e ndryshme që këta kanë nevojë për trajnime të ndryshme që të aftësohen profesionalisht. Unë mendoj që ne duhet të aktivizohemi të gjithë dhe të japim kontributin tonë që sa do ku do ta zbusim edhe çështjen e strehimit, banimit, punësimit dhe të infrastrukturës ne me radhë do t’i kemi edhe përgjigjet e drejtorisë që janë më të sakta qoftë për çështje të urbanizmit, shërbimeve publike, megjithatë mendoj që ne duhet të angazhohemi dhe ta bëjmë

integrimin e komuniteteve jo shumicë në atë nivel që e meriton. Unë me këtë rast që e përmenda edhe komunitetin rom sot është 8 prilli pra dita ndërkombëtare e komunitetit rom, komuniteti rom më 1971 ka mbajtur një asamble nga të gjitha trevat apo rajonet e botës që në kuadër të asaj e kanë shpallë ditën ndërkombëtare të komunitetit rom e sot është kjo ditë e shpresoj që si komunë dhe si qeveri të angazhohemi për ta që të kenë një jetë dhe mirëqenie më të mirë dhe ta ndiejnë vetën si komunitet i respektuar dhe i nderuar sepse përfaqësojnë një pjesë bukur të madhe në shtetin tonë prandaj shprehi rastin që tua uroj festën kombëtare të komunitetit rom që asgjëson me këtë datë që po e mbajmë këtë mbledhje, kjo është sa për fillim.

3. Informatë e Zyrës Komunale për Komunitete dhe kthim – ZKKK, rreth bashkëpunimit me Organizatën Ndërkombëtare për Migrim - IOM

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, ne me këtë organizatë kemi bashkëpunim të gjatë dhe kjo organizatë ka dhënë shumë projekte për komunitete jo shumicë prandaj lidhur me këtë z.Liman Zeqiri ka të dhëna më shumë i cili mund të na informojë për këtë organizatë që jemi në bashkëpunim me të.

z.Liman Zeqiri-shef i Zyrës Komunale për Komuniteteve dhe Kthim ZKKK, theksoi, ne e falënderojmë Organizatën Ndërkombëtare për Migrim – IOM, që merret shumë me migrimin dhe temën kryesore e ka stabilizimin ekonomik të komuniteteve jo shumicë. Duke e falënderuar edhe komunën që me këtë organizatë kemi edhe një memorandum mirëkuptimi që mund ta themi për 20 vite bashkëpunojmë së bashku, buxheti i kësaj organizate është bashkësia evropiane që ne duhet ta falënderojmë shumë këtë organizatë se kemi përfituar si komunë shumë prej saj dhe duhet të jemi shumë falënderues për këtë ndaj tyre që ende vazhdojmë me kontratën dhe memorandumin e mirëkuptimit për shumë projekte që janë jashtëzakonisht projekte të mira për rëndësinë e komuniteteve jo shumicë. Në kuptimin e kësaj organizate ne duhet ta falënderojmë edhe komunën që na ka përkrah me mjete financiare duke përfshi kryetarin aktual dhe gjithë kryetarët e më parshëm duke përfshi edhe digasteret kryesore, sidomos e falënderojmë DKA-në që absolutisht për çdo projekt kanë qenë të gatshëm që të realizohen që janë në interes të komuniteteve jo shumicë. Ne e dimë që përmes kësaj organizate të gjitha shkollat ku vijnë mësimet nxënësit e komuniteteve jo shumicë dhe nxënësve të komunitetit shumicë kanë përfituar kabinete që janë aktuale dhe të domosdoshme duke e falënderuar për kabinetet e shkencave natyrore, informatës, kulturës dhe të gjitha ato përfitime tjera që shkollat kanë përfituar falë projekteve dhe donacioneve të kësaj organizate dhe ne normalisht në vazhdim presim që edhe shumë projekte tjera t'i realizojmë. Ne e dimë që në kuadër të saj ka përfituar SHFMU “DR. Ibrahim Rugova”, SHFMU “Naim Frashëri”, SHFMU “Shaban Shala”, SHFMU “Ali Ajeti”, SHFMU “Luixh Gurakuqi”, SHFMU “Zahir Pajaziti” dhe në të gjitha lokalitetet ku jetojnë komunitete jo shumicë duke e falënderuar këtë organizatë ne i kemi pajisur të gjitha këto shkolla me të gjitha pajisjet. Nga kjo organizatë kanë përfituar edhe shumë familje që kanë vetë iniciativa për vet menaxhim për një stabilizim ekonomik për zeje të ndryshme kemi shumë raste më shumë se 12 apo 13 familje që kanë marrë projekte që janë mundësuar nga kjo organizatë me buxhetin e bashkësisë evropiane që ata të rigjenerojnë të hyra të tyre dhe të krijojnë një stabilitet ekonomik dhe t’ju ndihmojnë edhe të tjerëve që t’i punësojnë. Tani në procedurë e sipër kemi edhe 7 familje që i kemi vizituar dhe pritët që shumica prej tyre që i plotësojnë kushtet dhe kriteret ta marrin donacionin e mundshëm për të përfituar edhe në aspektin familjar dhe ekonomik për të pasë mundësi për punësim të dikujt tjetër, kjo është një qasje shumë e mirë për t’i rritur bizneset e vogla, ku de fakto ne bashkëpunojmë

jashtëzakonisht mirë me këtë organizatë por edhe në kuptimin e nivelit lokal që çdo herë në realizimin e projekteve ka qenë e nevojshme të participohet 30% që asnjëherë nuk kanë heziturar duke falënderuar drejtorin e DBF-së, që ka qenë strikt në realizimin e projektit dhe në bartjen e financave. Këto janë ato që neve si komunë na japin shumë prioritet dhe kur je një bashkëpunëtor serioz dhe i devotshëm atëherë nga organizata edhe projektet ofrohen sepse ne e dimë që ka komuna tjera që kanë më shumë komunitete jo shumicë dhe nuk kanë qenë aq të përgjegjshëm sa komuna jonë ku ne duhet të jemi falënderues ndaj IOM-it, ku në afatin shumë të shkurtër përgjigjja financiare është e saktë që neve na e japin te financat. Unë tash për një projekt të ri duke falënderuar drejtorin e DKA-së edhe në shkollën e mesme të lartë “Fan S. Noli” që është një shkollë që merret më shumë me zanate sepse është shkollë profesionale ku ne së bashku me organizatën e kemi vizituar këtë shkollë dhe duke parë nevojat e atyre nxënësve edhe të komuniteteve jo shumicë ku aty zhvillohet edhe mësimi jo formal atë që ju e cekët te enti i punësimit dhe normalisht janë drejtime që i shërbejnë të gjitha komuniteteve për përgatitje profesionale në kuadër të kësaj ka instalim elektrik, trafik rrugor, automekanik, instalim, ngrohje, kanalizim dhe ujësjellës, rrobaqepësi, do të thotë janë atraktive për të ardhë deri te përfitimi i tyre dhe në bazë të asaj që ne kemi vizituar kemi ardhë deri në përfundim të asaj që këtë shkollë ta ndihmojmë me një projekt që është instalim, ngrohje, kanalizim dhe ujësjellës, që kap një shifër prej 14,000.00€, duke falënderuar IOM-in dhe DKA-anë. Këtë desha t’ua japë si informacion që ne jemi duke bashkëpunuar me këtë organizatë dhe jemi falënderues që shumë familje pritet që këtë vit do të fitojnë mjete që mund t’i realizojnë projektet e tyre për të ardhë deri te përfitimi dhe mirëqenia e tyre që është e domosdoshme.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit për Komunitete, theksoi, ju falënderoj për këtë informatë të saktë i nderuar z.Liman Zeqiri, unë së bashku në koordinim me ju kemi qenë për realizimin e këtyre projekteve prandaj mund të them se kemi përfituar bukur shumë prej kësaj organizate të cilën e falënderojmë që së bashku me komunën na kanë mundësuar realizimin e këtyre projekteve.

4. Të Ndryshme

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit për Komunitete, theksoi, pasi që kemi përfaqësuesit e të gjitha komuniteteve në të gjitha lagjet ku jetojnë ju kisha kërkuar që t’i lajmëroni të gjithë ata fëmijë që nuk janë vaksinuar kundër fruthit t’i lajmëroni prindërit e tyre për vaksinimin e fëmijëve sepse drejtori më ka thirr dhe kam qenë në një takim me të, të cilin e falënderoj për interesimin e tij për shëndetin e fëmijëve të komuniteteve jo shumicë ku kemi bërë thirrje për vaksinim ku aq është interesuar drejtori ku ekipin e tij e ka dërguar edhe në lagje ku jetojnë komunitetet jo shumicë ku i kanë vaksinuar fëmijët e them këtë se kjo është për lëvdatë sepse me këtë është marrë masa për ndalimin e ndonjë epidemie siç ka qenë njëherë në Fushë Kosovë ku është izoluar një lagje e tërë, prandaj në rr. “Xhafer Meta”, ku jetojnë komunitete jo shumicë nuk e di si është gjendja se nuk kam të dhëna prandaj e kemi përfaqësuesen e tyre këtu e cila mund të na informojë se a janë vaksinuar fëmijët e asaj lagjeje.

znj.Sevdije Mustafa, theksoi, i kam vizituar të gjitha lagjet dhe them goxha një numër i madh i fëmijëve janë vaksinuar mirëpo në rr. “Xhafer Meta”, ku jetojnë komuniteti jo shumicë nuk kemi arritur t’i vaksinojmë disa fëmijë edhe pse kemi qenë në vizitë me Shkurten dhe përfaqësuesit e organizatës mirëpo problemi qëndron te prindërit e tyre se nuk e kuptojnë rëndësinë e vaksinimit. Sa i përket fëmijëve të cilët jetojnë në rr. “Ali Ajeti”, shumica prej tyre janë vaksinuar mirëpo është një familje që si ka vaksinuar fëmijët e tyre edhe pse ne jemi duke bërë vizita në të gjitha

lagjet dhe mund të them se ne si komunë nuk kemi shumë problem sa i përket vaksinimit, mund të them se 90% e fëmijëve janë vaksinuar.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit për Komunitete, theksoi, në rr. “Xhafer Meta”, cila familje nuk i ka vaksinuar fëmijët

znj.Sevdije Mustafa, theksoi, janë familjet Behluli dhe Halili që si kanë vaksinuar fëmijët e tyre kundër fruthit.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit për Komunitete, theksoi, ju si përfaqësuese të atyre duke ditë rëndësinë e vaksinimit nëse ata nuk dëshirojnë ose se dinë rëndësinë e vaksinimit ju lutem më lajmëroni dhe ne së bashku me drejtorin e QKMF-së do e marrim ekipin mjekësore dhe do shkojmë t’i vaksinojmë ata fëmijë që ende s’janë vaksinuar sepse nuk guxojnë të mbesin ata fëmijë pa vaksinuar, nëse ka nevojë ne duhet t’i drejtohem edhe policisë se s’kemi ç’a bëjmë tjetër se nuk mundemi për një njeri që si vaksinon fëmijët e tij t’i marrim në qafë disa fëmijë të tjerë prandaj mi sjellë emrat se intervenimi ka me qenë.

z.Liman Zeqiri-shef i Zyrës Komunale për Komuniteteve dhe Kthim ZKKK, theksoi, nuk duhet paragjykuar se vaksinimi është çështje vullnetare dhe ne duhet me i bind ata që në pyetje është shëndeti i fëmijëve e mbi të gjitha është në pyetje jeta e tyre mirëpo ne e dimë që edhe në pandemi që ka qenë obligative vaksinimi shumë persona nuk janë vaksinuar por bindja shkon deri te ajo që personeli shëndetësor e shpjegon rëndësinë e vaksinës për imunitetin dhe shëndetin e tyre që është paraparë me ligj ku prej lindjes e deri në një moshë të caktuar është paraparë vaksinimi i fëmijëve për të krijuar imunitetin e tyre, megjithatë ka raste të tilla që nuk i marrin këto vaksina por të gjithë ne e kemi për detyrë t’ju tregojmë atyre që vaksinimi është i domosdoshëm për ruajtjen e shëndetit të fëmijëve të tyre . Unë kam një ide që në kuadër të planit të punës që është miratuar në këtë kuvend t’i vizitojmë këto lagje sepse në majin shkurt kemi pas të caktuar vizitat dhe ato data kanë shkuar prandaj ne sot t’i caktojmë bashkërisht datat e vizitave në këto lagje dhe të bisedojmë për rolin dhe rëndësinë e vaksinimit por edhe ta dimë gjendjen e tyre faktike qoftë në infrastrukturë, punësim, banim. Mendoj që ta caktojmë datën e vizitës në lagjet dhe shkollën Dr. “Ibrahim Rugova” dhe t’ju shpjegojmë rëndësinë e vaksinimit.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit për Komunitete, theksoi, është ide shumë e mirë kjo vetëm të koordinohemi për datën e takimit.

z.Liman Zeqiri-shef i Zyrës Komunale për Komuniteteve dhe Kthim ZKKK, theksoi, atëherë le të jetë vizita në lagjet dhe shkollën dr. “Ibrahim Rugova” më datë 18.04.2025, ora 10:00, t’ju shpjegojmë rëndësinë e vaksinimit

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, atëherë u caktua data e vizitës dhe tema e diskutimit për rëndësinë e vaksinimit të fëmijëve, nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni, nëse jo atëherë e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:45

Procesverbalin e mbajti,
Enis Sheholli

Nr.Prot.01-060/04-0020057/25
Podujevë, 08 prill 2025

Kryesuesi i Komitetit
Xhafer Ademi